



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.09.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-2172/14, për z. Sadik Maloku, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Suharekës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-2172/14, që për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z. Sadik Maloku, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Therandës (Suharekës).

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Therandës (Suharekës), është duke ushtruar edhe funksion në veprimtari private, pra është identifikuar si person i autorizuar në një biznes privat, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 07.07.2014. e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Sadik Maloku, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Therandës (Suharekës), pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar që ti bëhet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit.

Zyrtarët e Agjencisë në takimin që është mbajtur me z. Maloku, me datën 01.08.2014 e kanë njoftuar me faktet që posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrim të funksionit publik, ndërsa, z. Maloku është pajtuar me gjendjen dhe është zotuar se në afat sa me të shpejt do të tërhiqet nga personi i autorizuar në biznesin private familjar, dhe do bëjë ndryshimet e nevojshme dhe do të shmanget nga situata e mundshme e konfliktit të interesit.

Me datën 12.09.2014, z. Sadik Maloku, ka sjell në Agjenci dokumentet zyrtare të lëshuar nga ARBK-ja ku dëshmohet se janë bërë ndryshimet e kërkuara dhe se në biznesin privat me nr. biznesi 80664982 dhe emër "Eko Farm" Sh.p.k - zyrtari në fjalë nuk figuron si person i autorizuar në këtë kompani pasi që është larguar nga personi i autorizuar në biznesin familjar por mban pozitën e pronarit si aksionar në këtë biznes.

Vlerësojmë se zyrtari i lartë publik me largimin e tij nga funksioni i personit të autorizuar në bizneset private "Eko Farm" Sh.p.k, ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

